



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E APELIT ADMINISTRATIV
TIRANË

NR.48/18/1/1 AKTI

VENDIM
NJOFTIMI ME SHPALLJE

Drejtuar: Gjykates se Apelit Administrativ.

Ne Gjykatën e Apelit Administrativ, vijon të shqyrtohet çështja administrative me:

PADITES: Pellumb Prençi.

TE PADITUR: - Prokuroria e Pergjithshme e Republikës së Shqipërisë.
- Presidenti i Republikës së Shqipërisë.

OBJEKTI: - Shfuqizim i Dekretit Nr.8744 Dt.15.10.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë;
- Kthimi i paditesit në detyrën e prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Pukë;
- Pagimin e pages së paditesit nga momenti i ndërprerjes, datë 2.11.2013 deri në ekzekutimin e vendimit të gjyqës;.
- Detyrimin e pales së paditur, Prokuroria e Pergjithshme të paguajë ndaj paditesit një shperblim të drejtë;
- Detyrimin e pales së paditur, Prokuroria e Pergjithshme për fshirjen nga dosja personale e prokurorit Pellumb Prençi të masës disiplinore "shkarkim nga detyra";
- Pezullimin e gjykimit të kesaj kerkespadie derisa të zgjidhet çështja penale në ngarkimin tim në Gjykatën e Shkalles së Pare Shkoder me vendim të formës së prere.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 15/2, 17/2, 18, 30, 31, 32/2, 33, 42, 48 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Nenet 1, 3, 6, 13, 14, 17 të Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut, Nenet 10,11 të Deklaratës Universale të Drejtave të Njeriut, Nenet 2, 14 të Paktit Nderkombëtar (Kartës së OKB-së) lidhur me të drejtat civile dhe politike, Nenet 2, 5 të Paktit Nderkombëtar (Kartës së OKB-së) lidhur me të drejtat ekonomike, shoqërore, kulturore, Nenet 1/1/b, 2, të Konventës Nr.11 të OKB-së "Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit", Nenet 1/1,2/2 të Konventës së OKB-së "Kunder torturës dhe denimeve a trajtimeve të tjera mizore, çnjerezore ose degraduese", Nenet 1,36,297/a të K.Pr.Civile, Nenet 1, 2, 9-20, 22, 23/1, 25, 35, 37, 41, 42, 49 e vijues të K.Pr.Administrative, Nenet 4, 7 të K.Pr.Penale, Nenet 2/1, 4/1/2, 8, 27, 28, 29, 30, 32, 33, 34, 39, 55/1, 56/5 të Ligjit

Nr.8737 Dt.12.02.2001 "Per organizimin dhe funksionimin e prokurorise ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar me Ligjin Nr.9102 Dt.10.07.2003 dhe Ligjin Nr.10051 Dt.29.12.2008, Nenet 1, 3, 7/a/ç, 10/2/b, 15/a/c, 16/2/b, 17/1/a/c/g, 18/1/b, 21, 34 te Ligjit Nr.49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimit e mosmarreshjeve administrative", Nenet 10,11 te Kodit te Etikes se Prokuroreve miratuar nga Ansambleja e Pergjithshme te Prokuroreve Dt.15 Tetor 2005, Nenet 1, 2, 3, 4 e vijues te Rregullos se Prokurorit te Pergjithshem Nr.78 dt.16.04.2010 "Per Kryerjen e inspektimit dhe fillimin e procedimit disiplinor", Nenet 2/3/5/6/2/a, 9, 10 e vijues te Rregullos se Prokurorit te Pergjithshem Nr.79 Dt.16.04.2010 "Per organizimin dhe funksionimin e Keshillit te Prokurorise".

Gjykata, bazuar ne Nenin 52 te Ligjit Nr.49/2012 "Per gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative", i ndryshuar dhe ne Nenet 133/b dhe 460 te Kodit te Procedures Civile, ne seancen gjyqesore te dates 20.11.2018, **vendosi te njoftoje paditesin Pellumb Prenci, nepermjet shpalljes, per seancen gjyqesore te dates 29.01.2019 ora 09.00.**

Nje kopje e shpalljes do te afishohet ne kendin e njoftimeve te Gjykates se Apelit Administrativ dhe ne faqen elektronike te kesaj gjykate, nje kopje ne te dy adresat e vendbanimit te paditesit.

Nje kopje e shpalljes, me konfirmimin e afishimit, t'i kthehet Gjykates se Apelit Administrativ.

Tirane, me 18.12.2018.

